

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIMIN
E PROJEKTEVE HULUMTUESE NË
SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

SFIDA PËR
HULUMTUESIT E RINJ
5 – PROJEKTET E GJELBËRTA





CILI ËSHTË **QËLLIMI** YNË?

- ▶ Të inkurajojmë nxënësit të gjejnë zgjidhje kreative për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor si një nga prioritetet kryesore si në botë ashtu edhe në vendin tonë.
- ▶ Mësuesit dhe nxënësit të punojnë së bashku për t'i kthyer idetë inovative në projekte të suksesshme dhe të bashkëpunojnë në drejtim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta.
- ▶ Me kuriozitetin e fëmijëve për të kuptuar botën, të rishikojnë të vërtetat paraprakisht të definuara.



KUSH MUND TË **APLIKOJË**?

Garuesi duhet të jetë një shkollë fillore ose e mesme që është:

- ▶ themeluar në përputhje me Ligjin për arsimin fillor, respektivisht Ligjin për arsimin e mesëm
- ▶ e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- ▶ posedon vendim për verifikim të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Secili garues duhet të paraqitet me ekip garues i cili përbëhet nga:

1-2 (një deri në dy) mësues/e
– lider/e të projektit

5-10 (pesë deri në
dhjetë) nxënës/e



ÇFARË PROJEKTESH HULUMTUESE **PRESIM?**

- ▶ Projektet hulumtuese duhet të jenë nga fushat e shkencave **natyrore** dhe **teknike**.
- ▶ Procesi i hulumtimit duhet të bazohet në “metodë shkencore”, respektivisht të përfshijë formulimin, testimin dhe konfirmimin/modifikimin e hipotezës me anë të eksperimentit dhe vëzhgimit.
- ▶ Projektet e propozuara duhet të rezultojnë në rezultate të dukshme, të tilla si: ese hulumtuese, përpunimi i detyrës së projektit, përpunim të produktit, material audio-vizual, material dixhital, etj.
- ▶ Projektet hulumtuese të propozuara duhet të jenë plotësuese të programit mësimdhënës dhe të korrespondojnë me aftësitë njohëse të grupmoshës.
- ▶ Rezultatet e projektit hulumtues duhet të jenë të zbatueshme në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor dhe të biodiversitetit.

KOHËZGJATJA:
DERI NË 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.



SHPENZIMET E PRANUESHME

SHPENZIMET E PARASHIKUARA NË BUXHETIN E PROJEKTIT
DUHET TË KORRESPONDOJNË ME AKTIVITETET E
PARASHIKUARA NË APLIKACIONIN E PROJEKTIT.

Shpenzimet e pranueshme për financim janë:

- ▶ furnizim dhe / ose marrja me qira e pajisjeve hulumtuese dhe zhvillimore (pajisje laboratorike, pajisje digjitale, etj.)
- ▶ furnizimi i materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim (përfshirë dhe pajisjet e zyrës)
- ▶ shpenzimet e destinuara për përpunimin e materialeve promovuese deri në 10,000 (dhjetë mijë) denarë
- ▶ shpenzimet administrative (tarifat bankare, paraqitja e llogarisë vjetore për llogarinë e caktuar të projektit, shpenzimet për publikimin e njoftimit të furnizimit publik)



ÇFARË VLERËSOHET?

25%

CILËSIA E PROPOZIM
-PROJEKTIT

20%

ZBATUESHMËRIA
E REZULTATEVE
TË HULUMTIMIT

25%

KAPACITETI I
EKIPIT TË PROJEKTIT

25%

PAJTUESHMËRIA E
PROJEKT-PROPOZIMIT ME
QËLLIMIN E THIRRJES PUBLIKE

Propozim-projekti i dorëzuar nga një shkollë që nuk është/
ka qenë shfrytëzuese e një shpërblimi në kuadër të thirrjeve të
mëparshme, Sfida për hulumtuesit e rinj 5%



VEÇANËRISHT INKURAJOHEN **PROJEKTET QË**

- ▶ Kanë karakter ndërdisiplinor
- ▶ Parashikojnë një qasje gjithëpërfshirëse në formimin e ekipeve (kanë përfaqësim të barabartë gjinor, përfshijnë fëmijë të etnive të ndryshme, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë të moshave të ndryshme, etj.)
- ▶ Janë dorëzuar nga shkolla të zonave rurale



SI VLERËSOHET?

► KONTROLLIMI ADMINISTRATIV I LAJMËRIMEVE

(nëse lajmërimi është i plotë dhe në përputhje me kushtet e pranueshmërisë të theksuara në thirrjen publike)

► VLERËSIMI I PARË I PROPOZIM-PROJEKTEVE

(para-përzgjedhja) kryhet nga Komisioni për vlerësim dhe zgjedhje

► PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE MË TË MIRA

- pas prezantimit të propozim-projekteve të parapërzgjedhura para Komisionit të vlerësimit dhe zgjedhjes



MËNYRA E APLIKIMIT

Secili garues duhet të:

- ▶ Dorëzoj projekt për aplikim me Buxhetin e projektit, të plotësuar, nënshkruar dhe shtypur në formular të përcaktuar nga ana e Fondit, të skanuar në formatin PDF.
- ▶ Formulari i Aplikimit të projektit është i disponueshëm dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit të Fondit përmes butonit "SHKARKO DOKUMENTACIONIN".
- ▶ Dorëzimi i aplikacionit të Projektit bëhet duke plotësuar të dhënat themelore dhe duke bashkangjitur aplikacionin e Projektit përmes butonit „APLIKO “.
- ▶ Dokumentet e nevojshme për aplikim janë të disponueshme në faqen e internetit të FIZHT – www.fitr.mk

THIRRJA ESHTË HAPUR:

nga data 20.09.2022 deri me 01.11.2022, ora 14:00.



PËR TË GJITHA INFORMACIONET SHITESË JU **MUND**:

Na vizitoni në zyrën e
Fondit në Shkup, adresa
QTQ, lokali 6, NJ.B. 220

Na shkruani në adresën
e postës elektronike:
predizvikzamladi@fitr.mk



SHPËRBLIMET

BUXHETI I PËRGJITHSHËM
PËR KËTË SFIDË ËSHTË

3.000.000

(TRE MILION) DENARË

SHPËRBLIMET DO TË JEPEN NË DY KATEGORI:

- ▶ Kategoria 1: Projekte hulumtuese në arsimin fillor
- ▶ Kategoria 2: Projekte hulumtuese në arsimin e mesëm

Buxheti i propozim projektit individual mund të jetë së paku 100.000 (njëqind mijë) denarë dhe nuk mund të kalojë 200.000 (dyqind mijë) denarë.

Mësimdhënësit/et të cilët do t'i udhëheqin ekipet e shpërblyera për projektin e realizuar me sukses do të marrin shpërblim në vlerë prej 30.000 (tridhjetë mijë) denarë për mësimdhënësit/e, mjete të cilat ata mund t'i përdorin për të blerë kompjuter personal, tablet, printer dhe/ose lloj tjetër pajisjesh të vogla digjitale të aplikueshme në procesin mësimor.



FALEMINDERIT PER **VËMENDJEN**

PO I PRESIM APLIKACIONET
**TUAJA DHE JU UROJME
SUKSESE**